

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ILIRJANA ÇELA
ADRESA Rr. Elbasanit, Nd. 38, Nr. 3
Njësia Bashkiake Nr. 2
TEL: 0672073999

KONTRATA TË TJERA

(SHITESË KONTRATE)

Nr. repertori: 1856

Nr. koleksioni: 544

Tirane më 11/11/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

***Akti noterial përbëhet nga 3 fletë**



A2024054120067765352



A2024054120067765352

E KONTRATËS SË SHITJES SË KUOTË

NR. 1619 REP., NR. 488 KOL., DATË 23.10.2024

(Për korrigjimin e numrit të kuotave)

Sot, më datë 11.11.2024, para meje Notere ILIRJANA ÇELA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rr. Elbasanit, Nd. 38, Nr. 3 Njësia Bashkiake Nr. 2, u paraqit personalisht:

PALË: Shoqëria IDI 2005, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K61507510N, me seli në adresë Lagjja Nr.13, Pallatet Idi 2005, Sektori Apollonia, Zona Kadastrale 8518, Nr Pasurie 9/227+4-N7, Volumi 67, Faqe 87, Durrës, përfaqësuar nga Administratori **Panajot Korani**, atësia Ramadan, amësia Nasibe, shtetas Shqiptar, lindur në Qukes, Librazhd dhe banues në DURRËS, me adresë Pavaresia 00690611; Nd. 22; H. 15; Ap. 39; Durrës; Durrës; 2008; Durrës, lindur më 10/11/1976, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033335122 dhe nr. personal H61110088G.

Dhe

PALË: Dionis Teqja, atësia Ahmet, amësia Salihe, shtetas Shqiptar, lindur më 25/06/1969, në Peqin, Elbasan dhe banues në Tiranë, me adresë Bajram Curri; Nd. 1824; H. 1; Ap. 013; Njësia Administrative Nr. 5; 1019; Tiranë, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Biometrike nr. BI6772203 dhe nr. personal G90625209W, .

(Bashkërisht referuar si "Palët")

BAZA LIGJORE: Kodi Civil, Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Statuti i shoqërisë HIDRO POWER PEQIN SHPK, Ligji per Noterine

DEKLARIME PARAPRAKE

- A. Ndërmjet Shitësit dhe Blerësit është lidhur Kontrata e Shitjes së Kuotës me nr. 1619 Rep., nr. 488 Kol., datë 23.10.2024 nëpërmjet së cilës Shitësi i ka shitur Blerësit 49% të pjesëmarrjes së tij në shoqërinë "HIDRO POWER PEQIN" SHPK, person juridik i së drejtës shqiptare, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr. NIPT L12414016P, me seli në adresën: Kashar YRSHEK Godine 2 katshe pranë Megatek, Shqipëri (më tej referuar si "Shoqëria").
- B. Palët në bazë të nenit 10 të Kontrës së Shitjes së Kuotës me nr. 1619 Rep., nr. 488 Kol., datë 23.10.2024 kanë vendosur që të lidhin këtë Shtesë Kontrate me qëllim që të korrigjohet numri i kuotave të përcaktuara në Kontratën e Shitjes së Kuotës me nr. 1619 Rep., nr. 488 Kol., datë



A2024054120067765352

23.10.2024 në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, sipas parashikimeve që vijnë.

NENI 1

Objekti

- 1.1. Objekti i kësaj Shtesë Kontrate është korrigjimi në Kontratën e Shitjes së Kuotës me nr. 1619 Rep., nr. 488 Kol., datë 23.10.2024 të numrit të kuotave të përcaktuara në të gjithë përmbajtjen e saj, duke mbetur të pandryshuara parashikimet e tjera kontraktore dhe qëllimi për të cilën palët e kanë lidhur atë.

NENI 2

Ndryshimet në Kontratën e Shitjes së Kuotës

- 2.1 Në Kontratën e Shitjes së Kuotës me nr. 1619 Rep., nr. 488 Kol., datë 23.10.2024 bëhen këto ndryshime:
- a. Në "Deklarimet paraprake" paragrafi "A" të Kontratës së Shitjes së Kuotës me nr. 1619 Rep., nr. 488 Kol., datë 23.10.2024, pjesa e fjalisë: z. Dionis Teqja, zotërues i 100 kuotave që përfaqësojnë një kuotë që i jep të drejtën e 100% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë "HIDOR POWER PEQIND" SHPK, bëhet: z. Dionis Teqja, zotërues i 1 (një) kuote që i jep të drejtën e 100% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë "HIDOR POWER PEQIN" SHPK;
 - b. Kudo ku në përmbajtjen e Kontratës së Shitjes së Kuotës me nr. 1619 Rep., nr. 488 Kol., datë 23.10.2024 është shkruar 49 kuota/kuotave **ndryshohet në 1 (kuotë)**;
 - c. Kudo ku në përmbajtjen e Kontratës së Shitjes së Kuotës me nr. 1619 Rep., nr. 488 Kol., datë 23.10.2024 është shkruar 51 kuota/kuotave **ndryshohet në 1 (kuotë)**.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet e Kontratës së Shitjes së Kuotës

- 3.1 Të drejtat dhe detyrimet e palëve si dhe të gjitha parashikimet e tjera kontraktore të Kontratës së Shitjes së Kuotës me nr. 1619 Rep., nr. 488 Kol., datë 23.10.2024 mbeten të pandryshuara dhe të vlefshme për sa nuk janë ndryshuar nga kjo Shtesë Kontrate.

Neni 4


Të ndryshme

- 4.1 Kjo Shtesë Kontrate bëhet pjesë integrale e Kontratës së Shitjes së Kuotës me nr. 1619 Rep., nr. 488 Kol., datë 23.10.2024 mbeten të pandryshuara dhe të vlefshme dhe hartohet në 3 (tre) kopje, të perbere nga 3 faqe, me vlerë të njëjtë ligjore nga një për secilën palë dhe një për Noterin.



A2024054120067765352

- 4.2 Unë Noterja verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

SHITËSI:**Z. DIONIS TEQJA****BLERËSI:****SHOQËRIA IDI 2005 SHPK**

Përfaqësuar nga ortakut i vetëm dhe Administratori
z. Panajot Korani

**NOTER**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ILIRJANA ÇELA
ADRESA Rr. Elbasanit, Nd. 38, Nr. 3
Njësia Bashkiake Nr. 2
TEL: 0672073999

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(AKSIONE)

Nr. repertori: 1619

Nr. koleksioni: 488 ;

Tirane më 23/10/2024


Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 6 fletë



A2024054120061977898



A2024054120061977898

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(SHOQERIA "HIDRO POWER PEQIN" SHPK)

Sot, ne Tirane më datë 23.10.2024, para meje Notere ILIRJANA ÇELA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rr. Elbasanit, Nd. 38, Nr. 3 Njësia Bashkiake Nr. 2, u paraqiten personalisht:

SHITES: **Dionis Teqja**, atësia Ahmet, amësia Salihe, shtetas Shqiptar, lindur në Peqin, Elbasan dhe banues në Tiranë, me adresë Bajram Curri; Nd. 1824; H. 1; Ap. 013; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 25/06/1969, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Biometrike nr. BI6772203 dhe nr. personal G90625209W.

dhe

BLERËS: **Shoqëria IDI 2005**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K61507510N, me adresë Lagjia Nr.13, Pallatet Idi 2005, Sektori Apollonia, Zona Kadastrale 8518, Nr Pasurie 9/227+4-N7, Volumi 67, Faqe 87, Durrës, përfaqësuar nga **Administratori Panajot Korani**, atësia Ramadàn, amësia Nasibe, shtetas Shqiptar, lindur në Qukes, Librazhd dhe banues në DURRËS, me adresë Pavaresia 00690611; Nd. 22; H. 15; Ap. 39; Durrës; Durrës; 2008; Durrës, lindur më 10/11/1976, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033335122 dhe nr. personal H61110088G.

(Bashkërisht referuar si "Palët")

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Statuti i shoqërisë HIDRO POWER PEQIN SHPK bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "HIDRO POWER PEQIN" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

DEKLARIME PARAPRAKE

A. Shoqëria "HIDRO POWER PEQIN" SHPK, është person juridik i së drejtës shqiptare, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr. NIPT L12414016P, me seli në adresën: Kashar YRSHEK Godine 2 katshe pranë Megatek, Shqipëri *(më tej referuar si "Shoqëria")*. Kjo shoqëri ka një kapital në vlerën totale prej ALL 100,000 (njëqind mijë lekë) dhe përbëhet nga një ortak z. **Dionis Teqja**, zotërues i 100 kuotave që përfaqesojnë një kuote që i jep të drejtën e 100% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë "HIDRO POWER PEQIN" SHPK.

B. Shitësi kërkon të shesë 49 kuota që përfaqesojnë 49% të pjesëmarrjes së tij në Shoqëri tek Blerësi në përputhje me kushtet e kësaj kontrate duke patur miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve sipas Vendimit datë 11/09/2024 që i bashkëlidhet kësaj kontrate.

C. Blerësi është i interesuar të blejë 49 kuota që përfaqesojnë 49% të pjesëmarrjes në Shoqëri duke fituar kështu të drejtën e zotërimit të një kuote të barabartë me këtë përqindje pjesëmarrje.

Për këto arsye, Palët, me vullnetin e tyre të plotë, të lirë e të pacënuar, vendosin të lidhin këtë Kontratë Shitblerje Kuote *(në vijim referuar si "Kontrata")*, me kushtet si më poshtë vijon:



A2024054120061977898

NENI 1 Objekti

1. Objekti i kësaj Kontrate është kalimi i të drejtës së pronësisë i 49 kuotave, të cilat përfaqësojnë 49 % (dyzet e nëntë përqind) të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë "HIDRO POWER PEQIN" SHPK dhe i të gjitha të drejtave të tyre nga Shitësi tek Blerësi kunddrejt çmimit, kushteve dhe modaliteteve të rëna dakort nga Palet në këtë kontratë.

NENI 2 Çmimi dhe mënyra e pagesës

- 2.1. Palët kanë vendosur që shitja e 49 kuotave të barabartë me 49% (dyzet e nëntë përqind) të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë "HIDRO POWER PEQIN" SHPK nga Shitësi tek Blerësi të jetë me çmimin total prej **EUR 294,000 (dyqind e nëntëdhjetë e katërmijë euro)**.
- 2.2. Palët kanë vendosur që ky çmim do të likujdohet nga Blerësi brenda 60 ditësh nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate në llogarinë bankare të Shitësit me të dhënat:

Banka: OTP BANK ALBANIA SH.A.

Nr. Llogarise: 000797351 EUR

IBAN: AL41902112090202030062784878

NENI 3 Kalimi i titullit të pronësisë

- 3.1. Titulli i pronësisë së 49 kuotave të barabartë me 49% (dyzet e nëntë përqind) të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë "HIDRO POWER PEQIN" SHPK nga Shitësi tek Blerësi kalon në ditën e pagimit të çmimit të shitjes siç është përcaktuar në nenin 2.2 të kësaj Kontrate.
- 3.2. Regjistrimi i Kontratës pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit do të ketë efekt deklarativ ndaj të tretëve dhe Blerësi fiton pronësinë mbi këtë pjesë që në momentin e përcaktuar nga neni 3.1 më sipër.

NENI 4 Pasojat e shitjes së kuotës

- 4.1. Palët bien dakord se pas nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe kalimit të titullit të pronësisë së kuotave nga Shitësi tek Blerësi, Shoqëria do të ketë këtë strukturë ortakësh:
 - I. **Z. Dionis Teqja** do të jetë pronar i 51 kuotave që përfaqësojnë një (1) pjesë të barabartë me 51% të kapitalit të Shoqërisë "HIDRO POWER PEQIN" SHPK;
 - II. **Shoqëria IDI 2005 SHPK** do të jetë pronar i 49 kuotave që përfaqësojnë një (1) pjesë të barabartë me 49% të kapitalit të Shoqërisë "HIDRO POWER PEQIN" SHPK.
- 4.2. Pjesëmarrja e palëve në të drejtat e detyrimit e shoqërisë në raport me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e saj, do të jetë efektive nga momenti i kalimit të titullit të pronësisë sipas nenit 3.1 të kësaj kontrate e në vijim. Çdo e drejtë apo detyrim i Shitësit në lidhje me shoqërinë, i cili daton përpara datës së nënshkrimit të kësaj kontrate, do të mbetet ekskluzivisht i tij.

NENI 5 Garancitë e Palëve



A2024054120061977898

5.1. Shitësi garanton Blerësin se:

- 5.1.1. Kuotat që ai zotëron në shoqëri dhe që janë objekt i shitblerjes sipas kësaj kontrate nuk janë subjekt sekuestrimi, ndalimi shitje, të drejte parablerje, garancie bankare, apo e ndonjë mjeti tjetër i cili siguron ekzekutimin e detyrimeve;
- 5.1.2. Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur shitjen e pjesëve që ai zotëron në kapital dhe që janë objekt i kësaj kontrate dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj;
- 5.1.3. Përmbushja e kësaj kontrate nuk do të rezultojë në situatë kundërligjshmërie, paligjshmërie apo pavlefshmërie, lidhur me Kontratën në vetvetë, Statutin e Shoqërisë, marrëdhënie detyrimesh mes Shoqërisë dhe të tretëve apo Shitësve dhe të tretëve, ose me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë;
- 5.1.4. Asnjë person i tretë fizik ose juridik nuk ka të drejta mbi kuotat objekt shitblerje;
- 5.1.5. Shoqëria nuk ka detyrime tatimore apo fiskale të prapambetura;
- 5.1.6. As shoqëria dhe as vetë Shitësi nuk janë pjesë e ndonjë procesi gjyqësor apo procedimi administrativ, i cili mund të rezultojë në hetimin e Shoqërisë ose në ngarkimin e detyrimeve mbi kuotat, kapitalin ose asetet e shoqërisë;
- 5.1.7. Garantoni Blerësin mbi sigurinë financiare për vazhdimin e projektit sipas Kontratës së Koncesionit nr. 4466 Rep., nr. 1597 Kol., datë 14.09.2009 të llojit BOT dhe shtesave të saj me objekt "Ndërtimin e Hidrocentralit të Peqinit", deri ne operimin e plote te tij.

5.2. Blerësi garanton Shitësin se:

- 5.2.1. Blerja e kuotave të Shitësit është në përputhje me vullnetin e tij;
- 5.2.2. Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur blerjen e kuotave objekt i kësaj kontrate dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apo miratimin paraprak të ndonjë personi tjetër, qoftë ky fizik apo juridik;
- 5.2.3. Përmbushja e kësaj kontrate nuk do të rezultojë në situatë kundërligjshmërie, paligjshmërie apo pavlefshmërie, lidhur me Kontratën në vetvete, marrëdhënie detyrimesh mes Blerësit dhe të tretëve, ose me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë;
- 5.2.4. Blerësi nuk ka detyrime tatimore apo fiskale të prapambetura.
- 5.2.5. Garantoni shitësin dhe shoqërinë HIDRO POWER PEQIN SHPK mbi sigurinë financiare për vazhdimin e projektit sipas Kontratës së Koncesionit nr. 4466 Rep., nr. 1597 Kol., datë 14.09.2009 të llojit BOT dhe shtesave të saj me objekt "Ndërtimin e Hidrocentralit të Peqinit", deri ne operimin e plote te tij.

NENI 6

Pagesat lidhur me ekzekutimin e kësaj Kontrate

- 6.1. Të gjitha pagesat lidhur me ekzekutimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate do të mbarten nga Shitësi.

NENI 7

Konfidencialiteti

- 7.1. Palët bien dakord që kjo Kontratë dhe çdo negociim parakontraktor do të trajtohet në përputhje me parimin e konfidencialitetit dhe se nuk do të transmetojë asnjë të dhënë apo informacion lidhur me



A2024054120061977898

marrëdhëniet tregtare, financiare apo ligjore të njëra-tjetrës, si dhe se nuk do të bëjnë asnjë deklaratë lidhur me ekzistencën, objektin apo parashikimet e kësaj Kontrate.

- 7.2. Palët përjashtohen nga detyrimi i ruajtjes së konfidencialitetit në rast se:
- 7.2.1. Pala tjetër ka dhënë pëlqimin me shkrim për transmetimin e të dhënave;
 - 7.2.2. Transmetimi bëhet në kuadër të përmbushjes së një detyrimi;
 - 7.2.3. Transmetimi i bëhet një këshilltari të shoqërisë, i cili është subjekt i detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit (psh. Avokatit, ekspertit konfabël);
 - 7.2.4. Nevojitet për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të Palës që transmeton informacionin ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
 - 7.2.5. Nevojitet për ndjekjen e interesave legjitimë të palës që transmeton informacionin ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
 - 7.2.6. Këto të dhëna janë bërë publike nga vetë pala tjetër dhe ndodhen në domain-in publik dhe/ose janë të aksesueshme nga persona të tretë;
 - 7.2.7. Këto të dhëna janë bërë publike ose i janë bërë të njohura palës që transmeton të dhënat nga persona të tretë.

NENI 8 Forca madhore

- 8.1. Për qëllim të kësaj kontrate, "Forcë Madhore" nënkupton një ngjarje që nuk shkaktohet dhe është përtej kontrollit të arsyeshëm të një prej palëve të kësaj Kontrate, e cila shkakton që përmbushja të detyrimeve të palës në këtë kontratë të bëhet ose e pamundur, ose aq jopraktike sa, në mënyrë të arsyeshme, të konsiderohet e pamundur duke pasur parasysh rrethanat. Ajo përfshin ndër të tjera, epidemitë, pandemitë, gjendjet e fatkeqësisë natyrore, luftën, mosbindjen civile, stuhitë, përmbytjet ose grevat.
- 8.2. Në rastet e ekzistencës së kushteve të Forcës Madhore, afatet e parashikuara në të këtë kontratë për ekzekutimin e detyrimeve mund të shtyhen nëse është e nevojshme për aq kohë sa zgjat Forca Madhore. Forca Madhore nuk përfshin pamjaftueshmërinë e fondeve ose moskryerjen e një pagese që duhet kryer sipas kontratës.

NENI 9 Komunikimi ndërmjet palëve

- 9.1. Të gjitha komunikimet ndërmjet palëve, si dhe kërkesat që ato kanë ndaj njëra tjetrës, do të kryhen në mënyrë shkresore ose nëpërmjet e-mail-it, në adresat dhe e-maillet e përcaktuara nga palët në pjesën e gjeneraliteteve të tyre.

Për Shitësin: **Dionis Teqja** - Bajram Curri; Nd. 1824; H. 1; Ap. 013; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë

E-mail – dionis.teqja@teqja.com.al
Celular: +355692060001

Për Blerësin: **IDI 2005 SHPK**, Lagjia Nr.13, Pallatet Idi 2005, Sektori Apollonia, Durres

E-mail – idi2005@yahoo.com
Celular: +355692055125

- 9.2. Në rast se personat dhe/ose adresat dhe/ose e-mail-et e mësipërme pësojnë ndryshime, Pala që i pëson ato ka detyrimin të njoftojë palën tjetër brenda 24 orësh nga momenti i ndryshimit. Në rast të kundërt, çdo komunikim në adresën e mëparshme do të konsiderohet i vlefshëm edhe pse mund të mos jetë marrë nga ana e Palës që ka ndryshuar personin e kontaktit dhe/ose adresën dhe/ose e-mail-in.



A2024054120061977898

- 9.3. Çdo komunikim ndërmjet palëve është konfidencial dhe nuk mund t'i transmetohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë personave të tretë me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 7.2 i kësaj Kontrate.

NENI 10 **Ndryshimet e kontratës**

- 10.1. Çdo ndryshim i kësaj Kontrate bëhet me pëlqimin e përbashkët të palëve dhe do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se bëhet me shkrim dhe në nënshkruhet nga të gjitha palët në këtë Kontratë.

NENI 11 **Interpretimi i kontratës**

- 11.1. Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti. Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saj interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.
- 11.2. Ligji i zbatueshëm për interpretimin e kësaj Kontrate do të jetë legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 12 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- 12.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Palëve lidhur me këtë Kontratë, palët duhet të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.
- 12.2. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, Kontrata do të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

NENI 13 **Të tjera**

- 13.1. Bashkëlidhur dhe pjesë integrale e kësaj Kontrate janë:

- 13.1.1. Kopje e letërnjoftimit të palëve nënshkruese;
- 13.1.2. Ekstrakt nga regjistri tregtar i Shoqërisë "HIDRO POWER PEQIN" SHPK;
- 13.1.3. Ekstrakt nga regjistri tregtar i Shoqërisë "IDI 2005" SHPK;
- 13.1.4. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shitësit për miratimin e lidhjes së kësaj Kontrate;
- 13.1.5. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Blerësit për miratimin e lidhjes së kësaj Kontrate.

Kontrata, hartohet në 4 (kater) kopje e përbërë nga 6 (gjashtë) faqe të barasvlefshme në gjuhën shqipe, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese, të cilët deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me ligjin nr. 101/2018, datë 28.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre në përputhje të plotë me ligjin.



A2024054120061977898

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

SHITËSI:

Z. DIONIS TEQJA

Dionis Teqja


Tef



BLERËSI:

SHOQËRIA "IDI 2005" SHPK

Përfaqësuar nga ortaku i vetëm dhe Administratori
Z. Panajot Korani



Panajot Korani



NOTERE

Ilirjana Gela



Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANË, SHQIPËRI
TEL/FAX.: 355 4 2420005
TEL: 355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

REZULTATET E KERKIMIT

Numri i Rezultatit të kerkimit:	D-20241023125318719
Data e Rezultatit të Kerkimit:	23.10.2024
Ora e Rezultatit të Kerkimit:	12:53:18
Lloji i Kerkimit:	Emri i Personit Fizik
Numri i Dokumentit:	D-400-158-616

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0

DIONIS AHMET TEQJA

Fundi i Rezultatit të Kerkimit

Fundi i Dokumentit



Erixa Hysaj



Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANË, SHQIPERË
TEL/FAX.: 355 4 2420005
TEL: 355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

REZULTATET E KERKIMIT

Numri i Rezultatit të kerkimit:	D-20241023125318719
Data e Rezultatit të Kerkimit:	23.10.2024
Ora e Rezultatit të Kerkimit:	12:53:18
Lloji i Kerkimit:	Emri i Personit Juridik
Numri i Dokumentit:	D-400-158-616

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0

HIDRO POWER PEQIN SH.P.K.

Fundi i Rezultatit të Kerkimit

Fundi i Dokumentit



SUBJEKTI KERKUES:

Emertimi
ILIRJANA IBRAHIM CELA P.F.

Eriza Hysaj

TE DHENAT E PERDORUESIT:

Emri dhe Mbiemri
ERISA HYSAJ



Shoqëria: HIDRO POWER PEQIN SHPK
NIPT: L12414016P

V E N D I M

Nr. II, Datë 11/09/2024

Sot, më datë 11/09/2024, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë HIDRO POWER PEQIN SHPK, shoqëri tregtare e regjistruar në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Nr. NUIS L12414016P, me seli në adresën: Tirane Kashar YRSHEK Godine 2 katshe pranë Megatek, Tiranë, Shqipëri.

Në mbledhjen e Asamblesë është i pranishëm ortaku i vetëm z. Dionis Teqja, zotërues i një kuote të barabartë me 100% të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë HIDRO POWER PEQIN SHPK. Mbledhja e sotme ka rendin e ditës si më poshtë vijon:

1. Dhënia e miratimit paraprak nga Asambleja e ortakëve të shoqërisë HIDRO POWER PEQIN SHPK për shitjen nga ortaku i vetëm z. Dionis Teqja të 49% (dyzetë e nëntë përqind) të pjesëmarrjes së tij në kapitalin e shoqërisë "HIDRO POWER PEQIN" SHPK tek blerësi shoqëria IDI 2005 SHPK me çmimin e përcaktuar dhe sipas kushteve të vendosura paraprakisht në Kontratën e Shitblerjes së kuotës bashkëlidhur këtij vendimi.

Asambleja e ortakëve, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës dhe pasi i gjetën ato në përputhje me vullnetin dhe interesat tregtarë të shoqërisë, në mbështetje të neneve 81 e vijues të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe Statutit të Shoqërisë HIDRO POWER PEQIN SHPK, me unanimitet,

V E N D O S I:

1. Riemërimin e Administratorit aktual të shoqërisë HIDRO POWER PEQIN SHPK z. Dionis Teqja për një afat 5 - vjeçar duke filluar ky afat nga data 02.12.2021;
2. Dhënia e miratimit paraprak nga Asambleja e ortakëve të shoqërisë HIDRO POWER PEQIN SHPK për shitjen nga ortaku i vetëm z. Dionis Teqja të 49% (dyzetë e nëntë përqind) të pjesëmarrjes së tij në kapitalin e shoqërisë "HIDRO POWER PEQIN" SHPK tek blerësi shoqëria IDI 2005 SHPK me çmimin e përcaktuar dhe sipas kushteve të vendosura paraprakisht në Kontratën e Shitblerjes së kuotës bashkëlidhur këtij vendimi;
3. Autorizohet Administratori i shoqërisë z. Dionis Teqja ose persona të autorizuar prej tij për të kryer regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ORTAKU I VETËM

DIONIS TEQJA



[Handwritten signature of Dionis Teqja]
[Handwritten signature of Dionis Teqja]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L12414016P	
2. Data e Regjistrimit	14/12/2011	
3. Emri i Subjektit	HIDRO POWER PEQIN	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	01/12/2011	
6. Kohëzgjatja	Nga: 01/12/2011	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Kashar YRSHEK Godine 2 kateshe prane Megatek.	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00	
9. Objekti i aktivitetit	Ndertimin dhe menaxhimin e Hidrocentralit mbi lumin Shkumbin dhe kanalin vadites Peqin-Kavaje.Shitjen dhe trasmetim te energjise se prodhuar.	
10. Administratori/ët	Dionis Teqja	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 02/12/2021	Deri: 02/12/2026
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	DionisTeqja	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: HIDRO POWER PEQIN E-Mail: protocol@teqja.com.al Telefon: 0692060017
15. Statusi:	Aktiv

Datë: 23/10/2024

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date: 2024/10/23 11:55:12 +02:00
L12414016P2024102311550443
2006



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	K61507510N
2. Data e Regjistrimit	06/03/2006
3: Emri i Subjektit	IDI 2005
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	12/12/2005
6. Kohëzgjatja	Nga: 12/12/2005
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Durres Durres DURRES Lagjja nr.13, Pallatet IDI 2005, Sektori Apollonia, zona kadastrale 8518, nr pasurie 9/227+4-N7, volumi 67, faqe 87, Durres
8. Kapitali	337.000.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	Punime dheu,sistemime,taracime terrenesh,punime hekuri,ndertime civile etj. Te jape mjetet dhe ambientet me qera. Ndertim hidrocentralesh dhe shitje me shumice e pakice te energjise elektrike. Implementimi dhe menaxhimi i projektit gjenerues te energjise elektrike, fotovoltaike, eolike, hidrike dhe veprave ndihmese. Prodhim i energjise elektrike nga burimet e rinovueshme. Ndertimi i objekteve hidroteknike, fotovoltaike, etj, te cilat bejne te mundur shfrytezimin e energjise qe gjenden ne natyre dhe qe jane te rinovueshme. Shitja me shumice dhe pakice e energjise elektrike tek operatoret, furnizuesit, tregtaret, konsumatorët e energjise elektrike brenda dhe jashte vendit. Blerja dhe shitja e energjise elektrike nga operatore te ndryshem privat apo shteteror, ne Bursen Shqiptare te energjise elektrike apo bursat e tjera brenda dhe jashte vendit. Transmetimi i energjise elektrike ne sistemin e tensionit te larte, funksion i cili perfshin transmetimin ose interkonjeksionin nderkombetar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

10. Administratori/ët	Panajot Korani	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 25/05/2021	Deri: 25/05/2026
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	PanajotKorani	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 337.000.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Durres Durres DURRES Kamion Mercedes Benz me targe AA 794 IX, nr L.13. Pallatet IDI 2005, Sektori Apollonia, ne Zone Kadastrale 8518, me Nr.Pasurie 9/277+4-N7, Volumi 67, Faqe 87	
	Durres Durres DURRES Kamion Mercedes Benz me targe DR 0693 E nr L.13. Pallatet IDI 2005, Sektori Apollonia, ne Zone Kadastrale 8518, me Nr.Pasurie 9/277+4-N7, Volumi 67, Faqe 87	
	Elbasan Librazhd LIBRAZH D Ndertesa me nr.pasurie 1, zona kadastrale 3687, Qarrishte	
	Durres Durres DURRES Kamion Mercedes Benz me targe AA 971 IX, nr L.13. Pallatet IDI 2005, Sektori Apollonia, ne Zone Kadastrale 8518, me Nr.Pasurie 9/277+4-N7, Volumi 67, Faqe 87	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: IDI 2005 E-Mail: idi2005@yahoo.com Telefon: 0692055125	
	Të Tjera: Depozitimi i vendimit te dates 15-06-2009, per caktimin e ekspertit kontabel te autorizuar Z. Fatmir Turkeshi me numer license 93, date 10-01-2001, per zmadhimin e kapitalit te shoqerise. Depozitimi i Vendimit Nr.1, date 01-03-2010, per caktimin e ekspertes kontabel Znj. Vera Lala, me nr. License 135, date 27-01-2005, per auditimin e pasqyrave financiare te shoqerise per vitin 2009 e ne vijim. Depozitimi i Vendimit datë 18-10-2010 për	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	caktimin e ekspertës kontabel Znj. Vera Lala, me nr. License 135, datë 27-01-2005, për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë.
15. Statusi:	Aktiv

Datë: 23/10/2024

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date: 2024/10/23 11:54:30 +02:00
K61507510N2024102311542274
2006